

LUIGI M. UGOLINI

BUTRINTI

Përktheu nga origjinali italisht Zef Simoni

hyrja nga

Fabrizio Bucci dhe Alessandro Ruggera

dhe kontribut të

Enrico Giorgi dhe Belisa Muka

BOTIMET TOENA

TIRANË



ALMA MATER STUDIORUM | DIPARTIMENTO
UNIVERSITÀ DI BOLOGNA | DI STORIA CULTURE CIVILTÀ

*Instituti Italian i Kulturës falënderon zonjën Alma Buratti Sanghellinin,
mbesë e Luigi Maria Ugolinit, e cila i dha këtij Instituti pëlqimin për botimin e librit.*

Shtypja është promovuar nga Instituti Italian i Kulturës në Tiranë.

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Edona Marku Huqi
Përkujdesja grafike dhe kopertina: Erdita Oshafi

ISBN 9789928817396

© 2024 Istituto Italiano di Cultura, Tiranë.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA
Rr. "M. Gjollësja" nr. 71, Tiranë 1023.
Kutia Postare 1420.
Email: botimet.toena@gmail.com
toena.porosionline@gmail.com
<https://toena.al>

PARATHËNIE

Arkeologjia në Shqipëri është e lidhur pazgjidhshmërisht me sitin e Butrintit, pjesë e trashëgimisë botërore të UNESCO-s që prej vitit 1997 dhe krenari e trashëgimisë së pasur historiko-arkeologjike me të cilën Vendi i Shqiponjave mund të mburret, pavarësisht territorit të tij të vogël. Butrinti është gjithashtu i lidhur pazgjidhshmërisht edhe me figurën e Luigi Maria Ugolinit, një arkeolog i ri italian, i cili në vitin 1924 erdhi në Shqipërinë jugore, me direktivë të Drejtorit të atëhershëm të Misioneve Arkeologjike Italiane në Lindje dhe me mbështetjen financiare të Ministrisë së Punëve të Jashtme, për të identifikuar sitet arkeologjike ku do të kryheshin punime kërkimore dhe gërmuese. Ugolini i dha një shtysë të rëndësishme rizbulimit të trashëgimisë arkeologjike shqiptare dhe me të drejtë mund të konsiderohet si një nga “etërit fisnikë” të Butrintit.

Qyteti i Butrintit ndodhet në zonën që korrespondon me Kaoninë e lashtë, një rajon i pasur me site arkeologjike, që formonte pjesën veriore të Epirit. Në këto troje, kultura të shumta janë mbivendosur gjatë shekujve, siç dëshmohet nga shtresimi domethënës arkitektonik, i cili karakterizon sitet kryesore. Gjatë shekujve, grekët, romakët, bizantinët dhe venecianët kanë pasuar njëri-tjetrin në Butrint, duke lënë në trashëgim zona të mrekullueshme monumentale, të cilat i kanë mbijetuar pjesërisht braktisjes dhe harresës që pllakosi më pas qytetin. Është mbi të gjitha falë shtysës që dhanë gërmimet arkeologjike të misionit të drejtuar nga Ugolini, të mbështetura më pas nga puna e arkeologëve shqiptarë e duke filluar nga shekulli XXI, edhe nga ekspertë të Vendeve të tjera, sidomos nga Italia, që parku arkeologjik i Butrintit ka mundur të rifitojë shkëlqimin e vet të lashtë dhe të përjetojë zhvillimin që e ka kthyer në një destinacion të lakmueshëm për turistët nga e gjithë bota.

Ugolini kapërceu Adriatikun në kërkim të qytetit të lashtë romak të Buthrotum-it, duke marrë gjithashtu informacione nga shkrimet e shkrimtarit të famshëm grek Polybius mbi qytetin e Finiqit, kryeqyteti i lashtë i Epirit dhe njëkohësisht një tjetër sit arkeologjik me rëndësi parësore, ku gjurmët e shkollës arkeologjike italiane janë mjaft domethënëse. Studimet dhe kërkimet

e tij u frymëzuan edhe nga faqet joshëse të Eneidës, ku poeti i madh Virgjili ndaloi për të rrëfyer mbërritjen e Eneas në Butrint, një vend që është pjesë e “Rrugës së Eneas”, atij filli të hollë të kuq që bashkon më së miri Romën me Trojën e lashtë dhe që aktualisht është një itinerar kulturor i njohur nga Këshilli i Europës. Ka fort të ngjarë që ndikimi i këtyre dy figurave të mëdha të së kaluarës, e ka shtyrë Ugolinin që të shkruajë kujtimet e tij, ku rrëfen zbulimet e bëra në tokën shqiptare, duke përshkruar me shumë hollësi zbulimet e jashtëzakonshme arkeologjike, si dhe duke shprehur emocionet e tij përballë atyre monumenteve aq shumë të dëshiruara.

Njëqind vjet pas zbulimit që revolucionarizoi panoramën arkeologjike shqiptare, është e drejtë të nderojmë figurën e Ugolinit, duke paraqitur një ribotim të rrëfimit të misionit të tij, botuar në vitin 1937, një vit pas ndarjes së tij të parakohshme nga jeta. Trashëgimia e rëndësishme e Ugolinit u përqaftua me sukses nga një brez i ri arkeologësh të shkëlqyer italianë të Universitetit të Bolonjës në fillim të këtij shekulli, në bashkëpunim të ngushtë me Institutin e Arkeologjisë në Tiranë dhe me mbështetjen e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar. Ky ekip i përbashkët italo-shqiptar, aktualisht i drejtuar nga profesor Enrico Giorgi dhe profesor Belisa Muka, gjatë fushatave të fundit të gërmimeve, ka bërë disa zbulime të jashtëzakonshme, duke konfirmuar vitalitetin e parkut arkeologjik të Butrintit, duke nderuar kujtimin e Ugolinit dhe duke i qëndruar besnik frymës së tij miqësore karshi Shqipërisë. Në fakt, në faqet e tij, arkeologu kishte shprehur disa herë, vlerësimin për Vendin e Shqiponjave dhe për mikpritjen bujare të njerëzve të tij. Ishte vetë Ugolini ai që ia arriti që marrëveshja kulturore e nënshkruar mes Italisë dhe Shqipërisë në vitin 1926, të përcaktonte se çdo objekt i gjetur gjatë zbulimeve arkeologjike do të mbetej në vendin e origjinës, në kundërshtim me praktikën e asaj epoke.

Jetë të gjatë Butrintit. Jetë të gjatë miqësisë Itali-Shqipëri.

Fabrizio Bucci

Ambasadori i Italisë në Shqipëri

HYRJE

Ka kaluar një shekull që nga pranvera e vitit 1924, kur Luigi Maria Ugolini, një arkeolog, end epa i mbushur tridhjetë vjeç, u ngarkua, nga Drejtori i Misioneve Shkencore Italiane në Lindje dhe nga Ministria e Punëve të Jashtme, të drejtojë një mision të parë eksplorues në Shqipërinë e Jugut, një mision i cili do të sillte fryte të jashtëzakonshme me zbulimin e Finiqit në fillim dhe të Butrintit më pas. Në kontekstin politik, që ndryshoi rrënjësisht me ardhjen e Fashizmit, kuptimi i misionit që iu besua Ugolinit u kushtëzua në mënyrë të pashmangshme nga politikat hegjemoniste drejtuar Adriatikut dhe Shqipërisë në veçanti nga Italia. Është e vështirë të përjashtohet ky sfond nga tabloja, gjithsesi e ndritshme, e karrierës shkencore të Ugolinit në Shqipëri, ashtu siç është e vështirë të imagjinohet se Ugolini nuk do t'i përmbahej frymës së kohës dhe nuk do të aspironte të përmbushte pritshmëritë prej tij. Një gjë e tillë duket qartazi tek faqet hyrëse të *Butrintit: Miti i Eneas*, përmbledhje e fushatave të para të gërmimeve të botuara pas ndarjes së tij nga jeta në vitin 1937 dhe që po ribotohet sot. Faqe hyrëse në të cilat Ugolini, duke sugjeruar paralelizmin me Schliemann-in e udhëhequr nga veprat e Homerit, kujton se si, duke ndjekur rrëfimin virgjilian, gërmimet në Shqipëri do të konfirmonin lidhjet e ngushta shpirtërore mes Romës dhe Butrintit, si dhe të kësaj të fundit me Trojën. Ugolini duket se konfiguronte këtu një vijë të qartë, duke e lidhur të kaluarën e rajonit me mitin e Romës, por, pas shlyerjes së detyrimit politik në hyrje, teksti i tij mbetet, pas gati një shekulli, një shkrim i këndshëm dhe emocionues, ku historia e eksplorimit, përshkrimi i sitit dhe analiza shkencore e zbulimeve, ndërthuren më së miri.

Ishte dëshira për t'u rikthyer lexuesve italianë dhe shqiptarë mundësinë për të lexuar tekstin e Ugolinit, ai që na bëri të vendosim të publikonim këtë botim të ri, në italisht dhe shqip, të *Butrinti: Miti i Eneas*. Libri u ribotua në vitin 1999 nga Instituti Italian i Kulturës në Tiranë, i cili më pas propozoi ribotimin anastatik të vëllimit të vitit 1937, një zgjedhje e cila, një çerek shekulli më vonë, u duk e përshtatshme të rishikohej. Jemi përpjekur kështu

t'i japim një vlerë të re tekstit të Ugolinit, duke e vendosur atë në mënyrë kritike në kontekstin historik në të cilin është shkruar dhe botuar për herë të parë. Teksti origjinal i Ugolinit është riprodhuar në tërësi dhe pa interpolime, por i shoqëruar me një hyrje të re dhe të thelluar, përgatitur nga profesorët Belisa Muka dhe Enrico Giorgi, drejtues shkencorë të misionit arkeologjik italo-shqiptar, dhe pa premisat politike të shkruara pas vdekjes së autorit, që nuk mbartnin asnjë rëndësi shkencore.

Vlera informuese dhe dëshmuese e librit *Butrinti: Miti i Eneas* vazhdon të mbetet ende e paprekur dhe e denjë për vëmendje, mbi të gjitha sot, në dritën e kërkimeve gati një shekullorë të kryera pas misionit të parë italian, nga arkeologë shqiptarë dhe misionet ndërkombëtare, përfshirë atë italo-shqiptar të Universitetit të Bolonjës, të mbështetur nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar. Një shekull studimesh dhe kërkimesh, në të cilin kontributet e reja teorike dhe teknologjike kanë ndryshuar rrënjësisht teorinë dhe praktikën e kërkimit arkeologjik, duke e bërë atë jo më fushë konkurrence për konfirmimin e hegjemonive kulturore dhe narrativave historiografike për përdorim në të tashmen, por anasjelltas, një vend të privilegjuar për ballafaqimin dhe bashkëpunimin mes studiuesve, të bashkuar nga një qëllim i vetëm, ai i të analizuarit, kuptuarit dhe rrëfyerit të historisë së një territori në shtresimet dhe kompleksitetet e tij të panumërta.

Alessandro Ruggera
Drejtore i Institutit Italian të Kulturës në Tiranë

ZBARKIME NË BUTRINT NË GJURMËT E ENEAS: NJË TRADITË E ARKEOLOGJISË ITALIANE DHE SHQIPTARE

Një flotë e vogël anijesh, e drejtuar nga një grup të mërguarish me në krye princin trojan Enea, lë pas kështjellat e Feakëve dhe çan ujërat që ndajnë ishullin e Korfuzit, për të përshkuar shpatet e pyllëzuara të maleve Keraunë, në kontinentin e quajtur Epir. Shpejt para tyre shfaqet një lagunë dhe anijet futen në hapësirën e qetë e të kripur, derisa gjejnë një vend të sigurt ankorimi në portin e Kaonëve, që popullojnë këto troje ende të panjohura. Pasi anijet ankorohen, Enea arrin në breg dhe përtej një pylli të dendur, del në një lirishte, ku shquan një figurë femërore, tek po gjerb, për nder të burrit të saj të humbur, Hektorit trim. Atëherë Enea e njeh Andromakën, kujton tok me të heroin e mundur nga Akili dhe mëson fatin e saj. Princat trojanë Heleni dhe Andromaka, robër të Neoptolemit, u çuan në Epir dhe, pas lirit, themeluan një qytet të quajtur Butrint. Kur Enea merr të largohet, pamja e qytetit i kujton atdheun e humbur dhe, përpara se të kalojë muret, bie në gjunjë në pragun e kësaj Porte të re trojane.

Parafraza e librit të tretë të Eneidës, na jep mundësinë t'i afrohem Butrintit në gjurmët e heroit të Virgjilit, duke ripërshkuar disa nga temat që e bëjnë këtë sit jo vetëm një monument të jashtëzakonshëm të lashtësisë, por edhe një vend letrar, ku miti dhe arkeologjia përqasen sërish njëri me tjetrin. Në traditën augustiane, Butrinti shndërrohet në skenën e një drame, në të cilën fatet e grave dhe burrave të humbur, bashkohen për t'u rizgjidhur përgjatë rrugësh të tjera, njëra prej të cilave është rruga e Perëndimit, ajo që të çon drejt mitit të themelimit të Romës. Në Butrint, një nga ndalesat e udhëtimit të Eneas, për herë të parë historitë e Trojës dhe Romës takohen dhe përzihen mes tyre. Që nga ky moment, Butrinti nuk do të jetë më vetëm një qytet epirot, por do të kthehet përgjithmonë në simbol. Qyteti i vogël i Pergamos së ideologjisë augustiane, do të kthehet në një Romë tjetër, kur italianët do të pushtojnë vendin e Shqiponjave dhe më pas, në një nga qytetet e Pirros apo kalaja e ilirëve, atëherë kur Shqipëria socialiste, do të dojë të tregojë gjenealogjinë e vet autoktone.

Gjithsesi, përpara se të përshkojmë zbarkimet e tjera në Butrint, ia vlen t'i kthehemi kontekstit në të cilin zhvillohet rrëfimi i Virgjilit, i cili bashkon tradita të ndryshme në një histori të vetme. Një variant bashkëkohor, për shembull, është

ai i Dionisit të Halikarnasit, që e vendos zbarkimin e Eneas pak më në jug, në gjirin e Ambrakisë, përballë ujërave ku fitoi Aktiumi, kremtuar me themelimin e Nikopolit, qytetit të ngritur për të festuar fitoren e Agripës dhe Oktavianit mbi Antonin dhe Kleopatrën. Prej këtu, Enea do të shkonte në Dodonë dhe më pas do t'i bashkohej Ankizit në Butrint. Në fillim të aventurës së tij, në fakt, princi trojan është një i arratisur pa drejtim, të cilit i duhet të pyesë orakullin e Zeusit, Dodonaiosin e strehuar nëpër male, në vendlindjen stërgjyshore të pellazgëve mitikë, për të zbuluar se është i destinuar të shkojë drejt perëndimit. Këto janë vendet ku zuri fill fati i Oktavianit.

Rizbulimi i Butrintit

Një mëngjes herët, në pranverën e vitit 1924, një arkeolog i ri nga Romagna, largohet nga streha ku kishte qendruar gjatë natës, falë mikpritjes së një bariu vllah, dhe nga gjiri i Diaporit përballë Butrintit, nisat drejt një kodre të quajtur Kalivo. Ndjek me hap dhe me vështrim një tufë lejkësh të bardhë, që i duket se i tregon rrugën e mbarë. Arkeologu italian ishte dërguar në Shqipëri për të eksploruar Vendin, në kërkim të një zone për të nisur kërkimet italiane, por edhe për të mbledhur informacion mbi Tokën e Shqiponjave, sipas mënyrës së figurave të shquara si nënkoloneli anglez Lawrence në Arabi apo si arkeologu francez Leon Rey, i cili ndërmori gërmimet në Apoloni, përgjatë bregdetit qendror-verior shqiptar. Ugolini përshkon shpejt Vendin dhe, me Virgjinin në dorë, si të ishte një Heinrich Schliemann i ri, ëndërron të gjejë Butrintin, ashtu si tjetri zbuloi Trojën. Pas mbërritjes në rajonin jugor të Sarandës, i cili e ka marrë emrin nga manastiri i dyzet shenjtorëve, që nga një kodër, dominon gjirin dhe fshatin e vogël bregdetar, atij i bëjnë përshtypje muret e fuqishme që shquan në kodrën e Finiqit, toponim i cili i bën jehonë lavdive të Finiqit të lashtë, kryeqytetit epiriot. Por objektivi kryesor i ekspeditës së tij ishte Butrinti dhe kjo na bën t'i rikthehemi historisë së atij mëngjesi fatlum pranvere. Fluturimi paqtues i lejkëve e drejton tek një kodër e rrethuar nga mure antikë, të quajtur Kalivo, e cila dominon bregun jugor të liqenit. Megjithatë, ai e kupton menjëherë se siti nuk mund të korrespondonte me përshkrimin e Virgilit për qytetin e Helenit dhe Andromakës dhe, pa e lëshuar veten, kthen vështrimin drejt kodrës që shtrihet në bregun përballë. Më tej, hipën në një monoksil, një barkë tradicionale e përfutur nga gërmimi dhe formësimi i një trungu, e manovrueshme në këmbë me anë të një rremi të gjatë, si të ishte gondola, dhe pothuajse në mesditë, arrin në bregun verior të kanalit të Vivarit. Sapo fillon të ngjitet në shpatet e pyllëzuara, e njeh menjëherë destinacionin e tij të dëshiruar dhe atë çfarë ka mbetur ende imponuese, nga muret dhe akropoli i Butrintit.

Papritur lodhja dhe vuajtja e udhëtimit zhduken dhe ai përshkohet i gjithi nga gëzimi i zbulimit. Ende i pangopur, të nesërmen, do të gjejë edhe rrënojat e kalasë helenistike të Malit Aetos, Çuka e sotme e Ajtoit, dhe për këtë do të shkruajë plot kënaqësi, se ka zbuluar tre qytete antike në vetëm dy ditë.

Në hyrje të librit, në të cilin i tregon publikut të gjerë, zbulimin dhe aventurën e tij arkeologjike, me titull “Butrinti. Miti i Eneas, Gërmimet”, i botuar pas vdekjes në vitin 1937, Ugolini lexon Virgjinin në akropolin e Butrintit dhe nuk e fsheh emocionin për rezultatet e arritura.

Në fakt, kërkimet e Misionit Italian, që pas vdekjes së Ugolinit u udhëhoq nga Pirro Marconi dhe më pas nga Domenico Mustilli deri në fillim të luftës, sollën rezultate të jashtëzakonshme, aq sa shumica e monumenteve, sot të dukshme në sitin UNESCO të Butrintit, u nxorën në dritë nga arkeologët italianë me mbështetjen e Ministrisë së Jashtme. Zbulimet u komunikuan menjëherë nga mediat e kohës, siç tregohet nga filmimet e shumtë të Istituto Luce dhe nga artikujt e revistave, gazetave apo nismave të tjera editoriale. Nga leximi i këtyre veprave del në pah interesi nga ana e Ugolinit, i cili duket kryesisht i sinqertë, por, pavarësisht kësaj, nuk mund të mohohet se kërkimet italiane ishin padyshim një mundësi për propagandë, pasi vëmendja mediatike u drejtua mbi të gjitha tek vullneti politik për të krijuar një sfond kulturor, i cili të motivonte pushtimin italian të Vendit. Ky frymëzim i dha krahë edhe disa iniciativave me ndikim të madh, si lundrimi i organizuar në vitin 1930 me rastin e dymijëvjetorit të Virgjitit i cili zbarkoi në Butrint, duke përshkuar rrugëtimin e Eneas dhe që u kremtua edhe me krijimin e një pulle filatelike. Megjithatë, nuk duhet harruar gjithashtu se shqiptarët ngritën një statujë, tashmë të zhdukur, për të përkujtuar Ugolinin dhe se edhe tani, në hyrje të parkut, ndodhet një monument për nder të Luigi Ugolinit, Hasan Cekës dhe Dhimosten Budinës, të njohur si protagonistë të arkeologjisë shqiptare në Butrint.

Duke iu rikthyer historisë së zbulimit, duhet pranuar se më tepër bëhet fjalë për një rizbulim. Në vitin 1435, në fakt, humanisti Ciriaco d’Ancona, i cili po udhëtonte nëpër rajonin e Sarandës, kishte kaluar Krishtlindjet në Butrint, ndërsa koloneli anglez William Martin Leake kishte zbarkuar në sit në vitin 1805, por përshkrimi i tij mbeti i pabotuar, për më shumë se tridhjetë. vjet. Shumicës së vizitorëve të mëparshëm, iu mungonte vullneti i fortë i arkeologut italian, për të hartuar arkeologjinë e rajonit, për të njohur dhe pozicionuar sitin metodikisht, me një dëshirë të pamatë për të filluar gërmimet. Për këtë arsye mund të themi se Ugolini ishte arkeologu i parë modern që rizbuloi Butrintin në pranverën e vitit 1924, ndaj në këto faqe po e ripërshkojmë atë ditë, pikërisht një vit pas njëqindvjetorit të zbulimit.

Aventura e një arkeologu

Ugolini lindi në 1895 në Bertinoro dhe u diplomua për arkeologji në vitin 1921 pranë Universitetit të Bolonjës, me një tezë mbi tema parahistorike. Rrugëtimi i tij formues u ndërpre nga Lufta e Madhe, gjatë së cilës u bë pjesë e forcave alpine, duke u nderuar me medaljen e bronzit për trimëri ushtarake, por që shkaktoi pasoja fatale për shëndetin e tij, të cilat do ta mundonin deri në fund të jetës. Pas diplomimit, ndoqi Shkollën Arkeologjike të Romës dhe kjo i mundësoi marrjen pjesë në disa prej projekteve më të rëndësishme kërkimore të kohës. Mes tyre përmendim gërmimet e Paolo Orsit në Siçili dhe ato në Forumin Romak nga Giacomo Boni, i cili pikërisht në ato vite ishte duke rinovuar arkeologjinë klasike, me futjen e metodës stratigrafike. Në pranverën e vitit 1924, Luigi Ugolini u ngarkua nga Roberto Paribeni, drejtor i Misioneve Arkeologjike në Lindje, për të kryer udhëtimin e tij të parë eksplorues në Shqipëri, që më pas u përsërit edhe vitin e ardhshëm. Hipoteza e zënies fill të një projekti italian u materializua shpejt, për të kundërshtuar nismën e ngjashme franceze, e cila tashmë kishte bërë të mundur fillimin e kërkimeve arkeologjike franceze, të udhëhequra nga Léon Rey, duke hapur jo thjesht një rivalitet shkencor, që do të karakterizonte gjenezën e arkeologjisë europiane në vendin e shqiptonjave. Siç dihet, në atë udhëtim ai mundi të arrijë për herë të parë në akropolin e Butrintit, duke rizbuluar një vend që do të shënonte fatin e tij. Ndër sitet që pati mundësinë të vizitonte, i lanë shumë mbresë rrënojat e mureve imponuese të Finiqit, ku në fakt arriti të kryente dy Fushata gërmimi mes viteve 1926 dhe 1927, përpara se t'i kushtonte pjesën tjetër të jetës Butrintit, nga viti 1928 deri në vitin 1936. Në atë periudhë, ai konceptoi një projekt në shkallë të gjerë, i cili i lejoi të nxirrte në dritë fragmente të mëdha të qytetit antik. Ideja e tij për arkeologjinë bazohej tek një këndvështrim afatgjatë, i cili nuk nënvlerësonte asnjërin nga fazat kryesore historike duke e vendosur sitin në një kontekst gjeologjik dhe mjedisor, si dhe në qendër të arkeologjisë së peizazhit përreth. Për këtë arsye, ai krijoi një grup kërkimor, i cili mirëpriti autoritete me aftësi të shquara, si topografin Dario Roversi Monaco, arkitektin Carlo Ceschi, epigrafin Luigi Morricone, arkeologun Alfredo Nuccitelli dhe projektuesin Luigi Epicoco, duke treguar një qasje të pazakontë multidisiplinare, e cila spikat përmes shkrimeve të tij. Edhe pse gërmimet e tij morën formën e gërmimeve të kryera domosdoshmërisht nga punëtorë vendas dhe gjithashtu të nxitura nga nevoja për të gjetur vepra arti dhe për të arritur rezultate të shpejta, me qëllim justifikimin e financimeve, nuk mungojnë përshkrimet e konteksteve të zbulimit të gjetjeve të rëndësishme arkeologjike dhe shumë fakte mund të nxirren nga numri i shumtë i fotografive, vizatimeve dhe relieveve topografike.

Në të vëtetë, ai kultivoi me sukses një pasion të veçantë për fotografinë, gjë që e ndihmoi edhe në rastin e disa ekspozitave. Së fundi, planet, prerjet dhe pamjet aksonometrike, të cilat sot do t'i quanim tredimensionale, të topografit Roversi Monaco, kanë vënë në dispozicion të studiuesve një dokumentacion të saktë, i cili prej kohësh ka mbetur i patejkalueshëm. Ambiciet e Ugolinit u mbështetën që në fillim nga qeveria italiane dhe vetë Musolini punoi për të siguruar që Ministria e Punëve të Jashtme, t'i jepte fonde që i kalonin ato të të gjitha misionëve të tjera në Lindje. Megjithatë, shpesh i është dashur të përballet me vështirësi të mëdha financiare, të diktura nga marrëdhëniet e vështira që kishte me Ministrinë e Arsimit, e cila do të duhej të siguronte materialisht shumat e caktuara. Siç u përmend më sipër, zbulimet arkeologjike u komunikuan menjëherë nga gazetatat e kohës dhe vetë Ugolini iu përkushtua bërjes së njohur të rezultateve, nëpërmjet konferencave të ndryshme që mbajti edhe në Shqipëri, përveçse në Europë. Ugolinit nuk i shpëtoi as potenciali si kineast, të cilin ai mundi ta shfrytëzonte falë dokumentarit të kuruar nga Istituto Luce. Madje u përurua një seri editoriale prestigjioze, e redaktuar drejtpërdrejt nga Ministria e Jashtme, e quajtur Albania Antica, ku përfshiheshin tre vëllimet kushtuar territorit, Finiqit dhe Butrintit, ky i fundit i botuar pas vdekjes. Projekti përfshinte gjithashtu monografi kushtuar teatrit, që mbeti e pabotuar për një kohë të gjatë, si dhe pagëzimore të Butrintit. Mbetet vetëm të shpresojmë se puna e tij në pagëzimoren e Butrintit, do të dalë në dritë së shpejti, ndoshta duke kërkuar në arkivat e Muzeut të Qytetërimit Romak, i cili ende sot, mban dokumente të çmuara. Gjatë gjurmimeve në Butrint, Ugolini iu përkushtua edhe të tjera studimeve prehistorike të rëndësishme, si ato mbi Maltën, që së fundmi janë botuar të plota dhe që dëshmojnë për aftësinë e tij si studiues i vëmendshëm edhe në një kontekst tjetër të Mesdheut qendror. Pavarësisht kësaj, figura e tij është lënë gjatë pas dore dhe anashkaluar me gjykime të pathelluara, të kushtëzuara nga përfshirja e tij në regjimin fashist. Ndarja e tij e parakohshme nga jeta, e cila ndodhi përpara pikës së kthesës së shënuar nga ligjet racore, e shpëtoi atë nga kalimi i periudhës më të errët të historisë së Vendit, por gjithashtu e kristalizoi imazhin e tij, duke nxjerrë në pah një gjykim anakronik, që shpesh ishte më shumë politik sesa shkencor. Në mënyrë paradoksale, arkeologët shqiptarë që e ndoqën dhe që iu desh të përballeshin me një periudhë tjetër të vështirë, këtë herë në historinë e Shqipërisë, mundën të kuptonin më mirë sesa bashkëkombësit e tij, vështirësitë e qenësishme të profesionit të arkeologut gjatë regjimeve totalitare. Vetëm në vitin 2000, me rifillimin e gjurmimeve italo-shqiptare në Finiq dhe më pas në Butrint, zuri fill një rivlerësim i duhur i veprës së tij, më në fund e vendosur në një këndvështrim thjesht arkeologjik.

Kthim në Butrint

Në vjeshtën e vitit 2015, mund të kujtojmë një tjetër zbarkim në Butrint, natyrisht më pak letrar dhe padyshim më shumë të lidhur me çështjet e rastit. Në atë periudhë, në fakt, një ekip arkeologësh nga Universiteti i Bolonjës, ishte angazhuar në Pompei, në Piano della Conoscenza, një operacion mbresëlënës për të dokumentuar gjendjen e ruajtjes së sitit, që i paraprinte operacionit në Piano delle Opere, në kuadër të Projektit të Madh të Pompeit, drejtuar nga Giovanni Nistri dhe Massimo Osanna. Bëhej fjalë për një mundësi të jashtëzakonshme që arkeologjia italiane munda të shfrytëzonte, për ta shndërruar problemin në mundësi, e aftë për të zhvilluar teknologji dhe metoda novatore, të cilat do ta lejonin të drejtonte vëmendjen në mënyrë të integruar tek trashëgimia arkeologjike e Vendit tonë,. Me atë rast, u hartua një protokoll i bazuar në dialogun ndërmjet kompetencave të ndryshme në fushën e arkeologjisë, arkitekturës, inxhinierisë dhe restaurimit, me synimin e qartë për të përdorur instrumentet e duhura për rilevimin topografik të një vendi të jashtëzakonshëm në listën e trashëgimisë së UNESCO-s. Në vjeshtën e të njëjtit vit, i njëjti ekip, së bashku me kolegët shqiptarë, ndërmori një projekt të ri në Butrint, duke sjellë përvojën e fituar në Pompei edhe në këtë kontekst. Të paktën në synimet e protagonistëve, nuk bëhej fjalë vetëm për të shfrytëzuar rrethanat favorizuese, por edhe për t'iu përgjigjur një detyre morale. Siç e pamë, në fakt, shumica e monumenteve të Parkut të Butrintit, u nxorën në dritë nga arkeologët italianë dhe pas gati një shekulli, filluan të shfaqeshin probleme serioze ruajtje. Përvoja italiane në fushën e ruajtjes së trashëgimisë kulturore, sigurisht që mund të japë ndihmesë edhe në këtë vend të jashtëzakonshëm të Mesdheut. Falë projektit kërkimor italo-shqiptar, që tashmë është duke u zhvilluar që nga viti 2000 në sitin pranë Finiqit, e gjithë kjo përpjekje mund të përsojë në një kuadër të përditësuar dhe tashmë të mirë-testuar të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Në muajin shtator, pra, një ekip arkeologësh nga Instituti i Arkeologjisë së Tiranës dhe Departamentit të Historisë, Kulturave, Qytetërimit pranë Universitetit të Bolonjës, në marrëveshje me Ministrinë Shqiptare të Kulturës dhe me Parkun Arkeologjik të Butrintit, si dhe falë mbështetjes së siguruar nga i njëjti Universitet dhe nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Republikës Italiane, inauguroi Projektin e ri të Butrintit, i cili grupon trashëgiminë e gjatë të kërkimeve të mëparshme italiane dhe shqiptare. Fryma e bashkëpunimit që gjallëron këtë projekt, pati gjithashtu nderin të përmendej edhe nga Presidenti Sergio Mattarella, gjatë vizitës së tij në Tiranë më 9 shtator të vitit të shkuar, në kuadër të aktiviteteve të promovuara nga Ambasada Italiane në Tiranë. Vitet e parë të punës iu kushtuan mbi të gjitha dokumentimit dhe analizës së Shenjtores

së Asklepit dhe mureve, pra dy prej monumenteve kryesorë të Parkut, të cilat në pika të ndryshme parashtronin probleme ruajtje. Dokumentacioni topografik i monumenteve të hulumtuara, u përftua falë një sondazhi me skaner lazer, të mbështetur nga incizime fotogrametrike në tokë, si dhe me dron. Gjithçka u pozicionua në mënyrë rigorozë përmes GPS-it të përdorur në modalitetin diferencial. Në këtë mënyrë u përftua planimetri në shkallë 1:50 dhe panorama të të gjitha seksioneve të ndryshme të mureve. Këto të fundit shërbyen si bazë për hartëzimin e problemeve statike dhe degradimit sipërfaqësor. Fryti i kësaj pune, i ndarë me arkeologët e Parkut, u vu në dispozicion për të lehtësuar veprimet e konsolidimit. Me pak fjalë, ishte një lloj Plani i Njohjes së Butrintit, ndonëse ende në një fazë paraprake dhe i kufizuar mbi të gjitha tek muret, që shfaqnin rreziqet më të mëdha statike.

Duke filluar nga viti 2018, rilevimi topografik u shoqërua me rilevimet e para stratigrafike përgjatë qarkut të murit, me synim përvetësimin e elementeve arkeologjike, edhe përsa i përket datimit të saktë të tij, që do të pasuronte leximin e fazave të ndërtimit, të kryera me metodat tipike të arkeologjisë së arkitekturës. Siç dihet, në fakt, hartëzimi i njësive të mureve stratigrafike lejon kryesisht zhvillimin e një vazhdimësie relative ndërtimesh dhe pjesësh murale, që pasojnë njëra-tjetrën, duke pasuruar palimpsestin me kalimin e kohës. Megjithatë, në mungesë të elementeve që mund të datohen me siguri, nuk është e mundur të arrihet në datime të sakta, të cilat do të lejonin caktimin e fazave të ndryshme të ndërtimit, në momente specifike historike. Në rastin e mureve të Butrintit, të ndërtuar me blloqe të mëdha guri vendas, nuk është e mundur të përshtaten kriteret menzio-kronologjike, si ato të përdorura, për shembull, duke pasur parasysh përkatësinë e tullave, në sisteme të caktuara matëse, tipike për një periudhë dhe jo për një tjetër. Për këtë arsye, kronologjia e murit, që nga koha e Ugolinit, është nxjerrë kryesisht në bazë të analizës së teknikave të ndërtimit dhe konsiderimeve historiko-topografike. Me fjalë të tjera dhe me njëfarë përafrimi, duke qenë se muret e Butrintit paraqesin dy teknika kryesore ndërtimi, planimetria dhe zgjerimi i tyre më pas, iu referuan dy momenteve kryesore historike. Në majë të akropolit ka disa seksione muresh kortinkë, të ndërtuara me blloqe të mëdha guri të papunuar, të nxjerrë në atë vend dhe të vendosur me një rregullsi afërsisht poligonale. Këto janë konsideruar si muret e vendbanimit të parë të datuar përgjithësisht në periudhën arkaike. Një qark i dytë, më i gjerë, i ndërtuar kryesisht si kortinkë e dyfishtë dhe me blloqe më të vogla *opus isodomum*, rrethon rrëzën e kodrës së akropolit dhe i referohet momentit të zgjerimit të qytetit helenistik. Natyrisht ka shumë faza të tjera, ripunime dhe dallime teknike që karakterizojnë qarkun, por këta janë sigurisht elementët kryesorë. Datimi i ndërtimit të parë mund të mbështetet edhe

në disa gjetje në akropol, megjithëse konteksti i saktë stratigrafik i origjinës nuk dihet. Muret helenistike, megjithatë, të studiuara mbi të gjitha nga Neritan Ceka për epokën antike dhe nga Gjerak Karaiskaj për atë mesjetare, u datuan në bazë të krahasimit të teknikës së ndërtimit, me objekte të tjera të njohura të zonës. Megjithatë, edhe këto site të përdorura për krahasim, shpesh datohen pa patur konfirmim stratigrafik. Pra, ishte i pranishëm rreziku i ndërtimit të një kështjelle gjigante të ngritur mbi krahasime jo të bazuara në të dhëna të caktuara arkeologjike, por më tepër të kushtëzuara nga pozicione ideologjike, që privilegjonin një epokë më tepër sesa një tjetër, sepse e konsideruar si përfaqësuese e një zhvillimi të caktuar kulturor.

Për këtë arsye, pikërisht në vitin 2018, u inaugurua Fushata e parë e rilevimeve stratigrafike përgjatë qarkut të murit. Duke qenë se bëhej fjalë për gërmime të kryera për t'iu përgjigjur një pyetjeje kërkimore specifike, pas shqyrtimit të kujdesshëm të çdo elementi tjetër paraprak, u përpoq kryerja e studimeve stratigrafike të synuara, të cilat u dokumentuan dhe u “rivarrosën” në mbyllje të çdo Fushate. Nuk duhet harruar se të bësh arkeologji në një vend të UNESCO-s, shpesh do të thotë të punosh mes njerëzve që vizitojnë sitin, ndonjëherë edhe në grupe mjaft të mëdha. Për këtë arsye arkeologët duhet të japin ndihmesë në pasurimin e perceptimit të sitit dhe jo në kufizimin e tij. Kjo mund të ndodhë duke rrëfyer dhe treguar atë që po bëhet, por edhe duke raportuar, në përfundim të punës, situatën ashtu siç është gjetur, përndryshe do të ekzistonte rreziku i shtimit të problemeve të ruajtjes, që padyshim synohet të kufizohen. Megjithatë, gjurmët e asaj që është fshehur edhe një herë nga toka, janë lënë dhe gjenden duke përdorur informacione të aksesueshme përmes kodeve QR të lidhura me faqen e internetit të projektit (<https://site.unibo.it/butrint/en>). Gjithashtu, dokumentacioni analitik i çdo strukture të zbuluar, do të lejojë që zbulimet e reja të merren në konsideratë në çdo kohë në planin e ardhshëm të menaxhimit të Parkut, i cili tashmë është plot me monumente për t'u ruajtur.

Në vitin 2019, hetimet stratigrafike përgjatë mureve arritën në kodrën e akropolit, ku ndodhen gjurmët më të vjetra të Butrintit dhe janë ende duke u zhvilluar.

Akropoli i Butrintit

“Me emocion më të fortë se sa ai që ndjeva tek komentoja Homerin mbi rrënojat e Mikenës, tani po lexoj Virgjilin në akropolin e Butrintit”. Këto janë fjalët e përdorura nga Ugolini pak përpara ndarjes së tij nga jeta, për të përshkruar ndjesitë e provuara gjatë kryerjes së kërkimeve arkeologjike në Butrint. Për shkak të pranisë më të vogël të rrënojave monumentale në krahasim me atë që shihet mbi

tokë, në shpate dhe në bazën e kepit të Butrintit, maja e akropolit nuk ka tërhequr në të njëjtën mënyrë interesin e arkeologëve.

Në zbulimet e tij topografike, Ugolini ishte i pari që identifikoi tre seksione muri, që i përcaktoi si pellazgjike, të ndërtuara në mënyrë poligonale, ndonëse me teknika jo uniforme. Arkeologu italian i konsideroi seksionet si pjesë të qarkut të parë të murit, i cili kufizonte dhe mbështeste pllajën e akropolit nga ana jugore.

Ugolini nxori gjithashtu në dritë edhe rrënojat e një bazilike paleokristiane në majën e akropolit dhe, pas tij, Domenico Mustilli kreu disa gërmime, të cilat, gjithsesi, nuk u publikuan asnjëherë në mënyrë shteruese. Studimet e kryera nga Mustilli, megjithatë, lejuan nxjerrjen në dritë të rrënojave të grykës së gurtë të një pusi, të interpretuar si një vend lutjesh, që përmbante materiale heterogjene, duke përfshirë një fragment qeramike korintike, të gdhendur me tre shkronja greke, të lexuara si inicialet e një dedikimi për Athinën. Më pas, arkeologu shqiptar Astrit Nanaj, fillimisht i vetëm dhe më pas duke përfshirë studiuesen greke Katherine Hadzis dhe specialistë të tjerë ndërkombëtarë, rifilloi hulumtimet në akropol, duke hapur një sektor të madh gërmimesh pranë mureve poligonale. Me atë rast u sollën në dritë gjetjet që datojnë në epokën protohistorike si dhe fragmente të shumta vazosh të lashta të importuara nga Greqia. Megjithatë, këto gërmime, pavarësisht se ishin të rëndësishme, mbetën në thelb të pabotuara dhe për to u dhanë vetëm informacione të shkurtra, pa referenca të sakta në kontekstin arkeologjik. Mirëpo, pikërisht mbi këtë bazë, u mbështet për një kohë të gjatë interpretimi i Butrintit të parë si vendbanim stinor i një bashkësie barinjsh, i ndjekur nga pushtimi i qëndrueshëm nga kolonët korfuzas. Në kohët më të fundit, arkeologët e Butrint Foundation, të drejtuar nga Richard Hodges, kanë rinisur kërkimet dhe mbi të gjitha kanë dokumentuar dhe studiuar edhe një herë sektorët e gërmuar më parë nga Ugolini dhe Nanaj. Një studim i fundit i kryer nga arkeologu amerikan David Hernandez, ka marrë në konsideratë kërkimet e mëparshme, duke hipotezuar praninë e një tempulli të lashtë të vendosur në majën lindore të akropolit, ku sot mund të admirohen rrënojat e bazilikës paleokristiane. Bazuar në dedikimin e gjetur nga Mustilli, ai hipotezon se tempulli i ishte kushtuar Athinës dhe e vlerëson atë si një ndërtesë peripterale, të ndërtuar ashtu si tempulli i Kardakit, në ishullin e Korfuzit. Duke rimarrë një hipotezë tashmë të formuluar nga Ugolini, ai beson se zbulimi me luanin që kafshon një dem, i ripërdorur si arkitrav në ndërtimin mesjetar të Portës së Luanit rrëzë kodrës së akropolit, i përket këtij tempulli.

Kjo është, me pak fjalë, historia e studimeve mbi akropolin e Butrintit, me të cilën na u desh të ndesheshim kur rifilluan kërkimet italo-shqiptare në vitin 2019. Kërkimet e reja u përqendruan mes Kalasë veneciane në perëndim dhe bazilikës paleokristiane në lindje, në thelb në dy sektorë, njëri pranë mureve përballë zonës tashmë të kqyrrur nga Astrit Nanaj dhe tjetri në zonën qendrore, në një territor ende

të paprekur nga studimet stratigrafike. Ky sektor i dytë, në të vërtetë përfshin edhe disa struktura muri, të cilat ndoshta ishin identifikuar nga Mustilli. Bëhet fjalë për një sekuencë shtyllash murature katrore, që duket se i përket një kompleksi monumental të epokës augustiane, ndoshta një godinë me portik, që shoqëronte rrugën e ngjitjes drejt lindjes, ku ndodhet pjesa më e lartë e akropolit. Pranë njërës prej këtyre shtyllave, gjenden fragmente guri të asaj që mund të ketë qenë gryka katrore e pusit të shenjtë, të zbuluar nga Mustilli. Nëse do të ishte kështu, largësia mes tij dhe tempullit kryesor në skajin lindor të akropolit, do të sugjeronte dy struktura të veçanta, të cilat nuk duhet domosdoshmërisht të kenë qenë të lidhura. Me fjalë të tjera, nëse fragmenti me dedikimin për Athinën ishte një shenjë e kultit që ndodhej aty pranë, më mirë ai duhet menduar si një kishëz e vendosur përgjatë rrugës së shenjtë, që të çonte tek tempulli kryesor. Strukturat romake mbulohen nga një rrjet i dendur ndërtesash të mëvonshme, që i referohen fazave mesjetare dhe veneciane të jetës së akropolit, të ruajtura në sipërfaqe dhe gjithashtu të dallueshme falë hartëzimit të kryer me radar depërtues në tokë. Nga ana tjetër, muret romake i kanë themele në thellësi, në kurriz të stratigrafive që përmbajnë rrënojat e ndërtesave të epokës helenistike, të vendosura në thellësi që variojnë nga një e gjysmë deri në dy metra, direkt në bregun shkëmbor. Bëhet fjalë për struktura gati të shembura, të dallueshme vetëm në disa fragmente të vështira për t'u lexuar, por që dëshmojnë qartë praninë e ndërtesave, të cilat datojnë afërsisht në shekullin III para erës tonë.

Akoma më interesante duket se është situata e konstatuar gjatë provave të gërmimit, të kryera pranë mureve poligonale. Këtu, vështirësia më e madhe u has në njohjen e stratigrafive tashmë të prekura nga gërmimet e mëparshme, në krahasim me ato ende të paprekura. Pas përpjekjeve të përsëritura që nuk ishin gjithmonë inkurajuese, në Fushatën e vitit 2021, më në fund, u bë i mundur diktimi i një pjesë të mbushjes së mureve arkaikë, ende e paprekur, e vulosur nga një rrugë kalimi e epokës helenistike, e cila mbështetej në profilin e brendshëm të mureve poligonalë.

Mund të imagjinohet se me çfarë kujdesi u bë i mundur vazhdimi i gërmimeve të stratigrafive, të cilat më në fund lejuan zhytjen e mistrisë në historinë e lashtë të Butrintit. Kjo bëri të mundur rikuperimin e disa fragmente vazosh korintike, ndër të cilat spikat një kotil dhe një kupë që datojnë në fund të shekullit VII dhe fillimit të shekullit VI para erës tonë, të ngjashme me ato të gjetura në të shkuarën, por të lidhura më në fund, me një stratigrafi të saktë. Falë këtij zbulimi, më në fund mund të konstatojmë, se muret e akropolit të Butrintit janë ndërtuar në periudhën arkaike, bazuar në dëshmi të qarta arkeologjike. Analiza e gjetjeve, ende duke u studiuar nga Nadia Aleotti, mund të hapë tema të mëtejshme për të reflektuar në të ardhmen. Në pamje të parë, në fakt, duket se bëhet fjalë për objekte të përhapura kryesisht në kontekste të shenjta, të cilat mund të jenë vendosur qëllimisht në

kohën e ndërtimit të mureve. Një përshtypje e tillë duket se konfirmohet nga zbulimi i katërmbëdhjetë predhave prej guri, të futura të gjitha së bashku në një gropë në mbushjen e mureve. Nëse do të ishte kështu, do të ishte një veprim ritual i kryer gjatë ndërtimit të mureve poligonalë, që shërbenin edhe si rrethim i shenjtë i akropolit. Vendosija e armëve brenda mureve është në fakt një praktikë e njohur, që synon të favorizojë, nëpërmjet ritualit, qëndrueshmërinë dhe kohëzgjatjen e tyre.

Rëndësia e një ene balte

Sugjerimet e nxitura nga gërmimet e reja, mund të gjejnë jetë të mëtijshme në një zbulim tjetër të bërë në të njëjtin kontekst. Bëhet fjalë për fragmentin e një kupe prej argjile të zezë, me një formë të ndeshur në epokën arkaike në zonën Adriatiko-Joniane, veçanërisht në kontekste të shenjta. Në gjendjen aktuale të kërkimit, ky do të ishte fragmenti i parë i një produkti tipik etrusk, i gjetur në këtë rajon. Prania e tij në një kontekst të pasur me qeramika korintike arkaike, hap si rrjedhojë disa skenarë sugjestionues, në rrugën e kolonistëve të parë grekë drejt Perëndimit, por mund të duket edhe si një lloj konfirmimi i traditës letrare. Mund të mendohet se bashkë me vazot, këta marinarë sollën me vete edhe historitë e tyre, përfshirë ato mbi udhëtimet e heronjve të mbijetuar nga Lufta e Trojës, në tokën e Epirit. Me fjalë të tjera, ky fragment argjile, duket se ka ndjekur rrugën e Eneas mbrapsht. Duke dashur të tregohemi më të kujdesshëm, kjo copëz sigurisht që na rrëfen diçka mbi marrëdhëniet tregtare dhe kulturore mes Epirit dhe bregdetit tirren, në një moment vendimtar për strukturimin e popullsisë së këtyre rajoneve.

Duke gërmuar në magazina

Pak para këtij zbulimi, erdhi viti i tmerrshëm i pandemisë, i cili megjithatë nuk e ndërpreu punën në terren në Butrint. Në fakt, mbi të gjitha, falë mbështetjes së kolegëve tanë shqiptarë, në vitin 2020, vazhduan aktivitetet në akropol, të përqendruara sidomos tek operacionet e mirëmbajtjes dhe pastrimit të zonës së gërmimit. Megjithatë, kjo nuk na ka penguar të kryejmë lloje të tjera kërkimesh, të cilat na kanë dhuruar kënaqësi të papritura. Falë bashkëpunimit me Simona Antolini, epigrafe e Universitetit të Maceratës, u bë e mundur gjetja e formave prej letre celuloze të disa mbishkrimeve të Butrintit, të bëra nga Luigi Morricone, i thirrur nga Ugolini në vitin 1933, për t'iu bashkuar grupit të specialistëve që e ndihmuan në gërmime. Morricone identifikoi tre grupe kryesore mbishkrimesh, që datojnë në përgjithësi midis shekujve III dhe II para erës tonë, të cilat përfshinin ato kremtuese të ndërtimit të teatrit, ato të lirimit të skllëvërve, të gdhendura në

analemën e *parodos* perëndimore dhe ato, kronologjikisht të mëvonshme, të bëra mbi diazomë. Pas vdekjes së Morricones, i cili i vazhdoi studimet epigrafike mbi Butrintin edhe në Shkollën Arkeologjike Italiane të Athinës, këto forma mbërritën në Itali dhe përfunduan në magazinat e Universitetit të Maceratës, ku ende ruhen. Falë bashkëpunimit mes universiteteve, u bë e mundur përgatitja e dokumentacionit digjital jashtëzakonisht analitik të tyre, i dobishëm për qëllime studimore por edhe për vlerësim. Duhet të imagjinojmë, në fakt, se ndonjëherë këto forma të bëra gati një shekull më parë, lejojnë lexueshmëri më të madhe sesa epigrafët, të cilët kanë qenë të ekspozuar karshi elementeve klimatike për një kohë të gjatë.

Kërkimet janë ende në vazhdim

Ndonëse historia e Butrintit pasurohet vazhdimisht nga puna në terren e projekteve të shumta kërkimore, të promovuara në bashkëpunim me arkeologët shqiptarë, mbetet ende shumë për t'u bërë. Muret mesjetare janë në qendër të vëmendjes së studiuesve anglo-saksonë, të udhëhequr nga Richard Hodges dhe Nevila Molla, forumi romak po gërmohet nga arkeologët amerikanë, të koordinuar nga David Hernandez dhe Dhimiter Çondi, ndërsa projekti italo-shqiptar vazhdon kërkimet e tij si në sit, ashtu edhe në zonën përreth. Së bashku me ekipin e drejtuar nga Stefano Medas, hulumtimet nënujore të kryera në kanalin e Vivarit, bënë të mundur identifikimin e vendndodhjes së mundshme të Porto Pelodës, të përmendur nga Straboni dhe dokumentimin e rrënojave të zhytura në ujë të urës së epokës romake, e cila lidhte kepin e Butrintit me fushën përballë. Për më tepër, një sezon i ri kërkimesh arkeologjike të peizazhit ka nisur në zonën përreth qendrës antike, për ta vendosur Akropolin e Butrintit në qendër të një konteksti më të gjerë territorial përreth. Kjo pjesë e fundit e punës është pjesë e një projekti më të gjerë për Kaoninë bregdetare, ku përfshihen edhe kolegë nga misionet e tjera arkeologjike, të cilët po punojnë në Finiq dhe Çukën e Ajtoit, të koordinuar nga Giuseppe Lepore dhe Belisa Muka, si dhe nga Julian Bogdani dhe Albana Meta. Në këtë mënyrë bashkëpunimi italo-shqiptar, do të rikthehet për të fuqizuar më tej traditën kërkimore, të inauguruar në këto site nga vetë Ugolini njëqind vjet më parë.

Enrico Giorgi, Belisa Muka

*Departamenti i Historisë, Kulturave,
Qytetërimit pranë Universitetit të Bolonjës
Institutit i Arkeologjisë Tiranë
Drejtore të Projektit Italo-Shqiptar në Butrint*

BIBLIOGRAFIA

Faqja web: <https://site.unibo.it/butrint/en>

Aleotti N., Carbotti F., D'Ambola F., Kaca T. 2022, "La ripresa degli scavi sull'acropoli di Butrinto. Considerazioni preliminari sullo scavo delle mura arcaiche", *Cronache di Archeologia* 41, pp. 117-142

Castignani V. 2022, "Il nuovo rilievo delle mura arcaiche di Butrinto (Albania)", *Cronache di Archeologia* 41, pp. 163-178

Castignani V., Pizzimenti F. 2023, "Fotografia aerea storica e da drone per lo studio di un contesto lagunare: il caso di Butrinto (Albania)", *Archeologia Aerea* XV, pp. 100-109

Benfatti M., Castignani V., Pizzimenti F. 2020, "Le Fortificazioni di Butrinto: nuove acquisizioni topografiche e stratigrafiche.", in L.M. Calì, G.M. Gerogiannis, M. Kopsacheili (eds.), *Fortificazioni e società nel Mediterraneo occidentale. Albania e Grecia settentrionale*, Roma, pp.183-200

Giorgi E. 2022, "The destruction of Epirus after Pydna. Archaeology and literature", in M. Cipriani, E. Greco, A. Salzano, L. Tornese (eds.), *Dialoghi sull'Archeologia della Magna Grecia e del Mediterraneo. Atti del V Convegno Internazionale di Studi. Paestum, 19-21 novembre 2020*, Paestum, pp. 91-106

Giorgi E. 2022, "Another Greece. The population of northern Epirus and the genesis of Butrint in the Archaic period" in R. Brancato, L.M. Calì, M. Figuera, G.M. Gerogiannis, E. Pappalardo, S. Todaro (eds.) *Σχήματα. La città oltre la forma. Per una nuova definizione dei paesaggi urbani e delle loro funzioni: urbanizzazione e società nel Mediterraneo pre-classico*, Roma, pp. 461-485


Giorgi E., Bogdani J. 2012. *Il territorio di Phoinike in Caonia*. Bologna

Giorgi E., Lepore G. 2020, "Comparing Phoinike and Butrint. Some remarks on the walls of two cities in Northern Epirus", in L.M. Calì, G.M. Gerogiannis, M. Kopsacheili (eds.), *Fortificazioni e società nel Mediterraneo occidentale. Albania e Grecia settentrionale*, Roma, pp.153-181

Giorgi E., Muka B. 2023, "Sulle orme di Enea. Pascoli, laghi e città d'Epiro: le vie d'accesso a Butrinto", *Atlante Tematico di Topografia Antica* 33, pp. 239-257

Muka B., Giorgi E. 2022, "Kerkimet arkeologjike në Butrint gjatë vitit 2021", *Candavia* 9, pp. 67-74

Rivoli M., Sigismondo G., Tempera M., Dodaj D. 2022, "L'archeologia sull'acropoli di Butrinto e i nuovi scavi", *Cronache di Archeologia* 41, pp. 143-162



LUIGI MARIA UGOLINI

8 shtator 1895
Bertínoro

4 tetor 1936
Bolonjë

BUTRINTI

MITI I ENEAS GËRMIMET

NGA

LUIGI M. UGOLINI

Një ditë plot dritë të pranverës së vitit 1925, i ulur në murin e akropolit të Mikenës, lexova edhe një herë vargjet e Homerit mbi gjakësitë e Atridëve që kishin ndodhur po në atë vend; rilexova edhe aktin e parë të “Qytetit të Vdekur” të d’Anuncios, e mendjen ma pushtoi një nga ato emocionet e forta shpirtërore që mund të trondisin një jetë të tërë.

Nën përshtypjen e thellë të atyre gjërmadhëve të lashta, të cilat dukeshin sikur po ngjallehin nga të puthurat e ngrohta të diellit të Argolidës, humba në ëndërrime. E sikur pashë brumbujt e artë e maskat e arta që mbulonin fytyrat e kufomave të gjetura vite më parë në Mikenë të shkëlqenin me vezullime më të gjalla nga ç’më qenë dukur në të vërtetë disa ditë më parë, kur po i kundroja në vitrinat e muzeumit të Athinës.

Ndërsa një puih ere më sillte kundërmimin e rëndë të luleve të fushës, ndjeva të më pushtonte një dëshirë e thellë emulacioni: ia kisha zili veprën zbuluesit fatmadh të Mikenës. Me gjërmimet që kishte bërë në Tirint, Mikenë e Trojë, Shlimani kishte provuar se në epokën homerike, që deri atëherë mbahej tërësisht dhe vetëm si gojëdhënë, mund të shquhej, e qartë dhe e pakundërshtueshme, bërthama e një historie të vërtetë.

Atë ditë, duke u lënë fre të lirë ndjenjave, unë nuk dëshiroja vetëm ta gjeja a kishin apo nuk kishin qenë vërtet të Atridëve të vranë tradhtisht nga Egjisti, kur po ktheheshin ngadhënjimtarë në atdhe, varret që Shlimani kishte zbuluar brenda ledheve të Mikenës: mendimet më endeshin, me admirim të përmalluar, drejt atij burri që besimi i fortë e vullneti i hekurt e kishin çuar në fitore dhe që me dëshminë e arkeologjisë u kishte dhënë goditje vdekjeprurëse arsyetimeve të ftohta filologjike.

Në këtë admirim të përmalluar timin që atëherë kishte edhe një program veprimtarie. Atëherë ndoshta mund të mos kem pasur këtë vetëdije që kam sot, po atë do ta fitoja më vonë. Me kalimin e kohës, pas shumë përpjekjesh e dështimesh, shpresash e zhgënjimesh, po gjithnjë i mbështetur në një besim të patundur, fillova të hidhja themelet e asaj që jam duke bërë tani.

Megjithatë, nuk do të doja të më keqkuptonin, të më gjykonin mendjemadh dhe, ca më keq, të përhumbur në ëndërrën e ëmbël të botës mikene...

Me një emocion më të thellë nga ç'ndieja duke studiuar Homerin në gërmadhat e Mikenës, tani po lexoja Virgjilin në akropolin e Butrintit, që e kisha zbuluar e gërmuar vetë.

Edhe në qoftë se, deri tani, nga gërmadhat madhështore të Buthrotumit të lashtë nuk kanë dalë në dritë punime të bukura argjendarie, prapëseprapë çdo ditë shfaqen monumente përherë e më të rëndësishme të këtij qyteti, i cili, i ndërtuar sipas gojëdhënës nga Heleni i mërguar në shëmbëllesën e Trojës-nënë, më vonë do të frymëzonte Enenë të themelonte një qytet në brigjet e Tibrin.

Lidhjet shpirtërore midis Romës e Butrintit dhe midis këtij qyteti e Trojës bëhen edhe më të forta.

Prandaj me një ndjenjë krenarie kombëtare të shëndoshë, mendje, zemra dhe mjete të Italisë Fashiste, në hyrjen e dymijëvjeçarit të dytë të Augustit, gërmojnë në Buthrotum, në të lulëzuarën "Colonia Augusta".

L.M.U

Në Romë, më 9 maj 1936